



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.484/6 prot.

Datë 03.03.2026

**V E N D I M**

**Nr. 331/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.03.2026 shqyrtoi ankesën me;

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*REJ*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. *REF-62426-09-23-2025*, me objekt: “*Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës*”, me fond limit 245,035,563.59 (dyqind e dyzet e pesë milion e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH ose 2,530,574.86 (dy milion e pesëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 20.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

Skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*AIR*” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Clean Fast*” SHPK, në

procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “*REJ*” SHPK me NIPT: J93711608Q dhe me adresë: *Rruga “Dritan Hoxha”, Ngjitur me Shkollën “Ahmet Gashi” Kulla Jeshile, Nr.Pasuri 8/374 /ND+3-6, H, Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:**

Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A  
*Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).*

**Subjekte të interesuar:**

Operatori ekonomik “*AIR*” SHPK me NIPT: L51712008C, dhe me adresë: *Rruga “Siri i Kodra”, Nr. 8340, Nr. Pasurie 5/450, Njësia Administrative Nr.8, Tiranë.*

Operatori ekonomik “*Clean Fast*” SHPK me NIPT: L61807037R, dhe me adresë: *Bulevardi “Bajram Curri”, Godina ETC, Kati 13, Tiranë.*

Operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK me NIPT: K91413010N, dhe me adresë: *Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga “Fatmir Haxhiu” Pallati 2, Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati I Tiranë.*

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 24.09.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-62426-09-23-2025, me objekt: “Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 245,035,563.59 (dyqind e dyzet e pesë milion e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH ose 2,530,574.86 (dy milion e pesëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 20.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

II.2. Në datë 20.10.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi fazën e parë të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, ku shprehën interesin operatorët ekonomikë, si më poshtë vijon:

1. *Operatori ekonomik “AIR” SHPK*
2. *Operatori ekonomik “Clean Fast” SHPK*
3. *Operatori ekonomik “REJ” SHPK*
4. *Operatori ekonomik “NRG” SHPK*
5. *Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK*

II.3. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) konstatohet, se në datën 04.11.2025 operatorët ekonomikë të cilët kanë shprehur interesin në fazën e parë në procedurën e

prokurimit objekt - ankimi janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të shprehjes së interesit, si më poshtë vijon:

- |  |              |
|--|--------------|
| 1. Operatori ekonomik "AIR" SHPK             | kualifikuar  |
| 2. Operatori ekonomik "Clean Fast" SHPK      | skualifikuar |
| 3. Operatori ekonomik "REJ" SHPK             | skualifikuar |
| 4. Operatori ekonomik "NRG" SHPK             | skualifikuar |
| 5. Operatori ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK | skualifikuar |

II.4. Në datën 04.11.2025, operatori ekonomik "REJ" SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin në fazën e parë të shprehjes së interesit, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

*"1. Operatori ekonomik "Rej" sh.p.k, nuk ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 1, shkronja a), pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, Seksioni D – "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës", nuk ka specifikuar dokumentin apo adresën konkrete ku autoriteti kontraktor mund të verifikojë deklaratimet e mëposhtme:*

- Garantimin e mbrojtjes së të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, sipas legjislacionit në fuqi;*
- Lidhjen e kontratave të punës dhe garantimin e masave të sigurisë e shëndetit në punë, veçanërisht për grupet e rrezikuara;*
- Mungesën e masave ligjore në fuqi të vendosura nga ISHPSHSH, apo adresimin e tyre brenda afateve në rast shkeljesh të konstatuara.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme \_\_\_\_\_*

*Mungesa e informacionit për verifikim e bën të pamundur vërtetimin e deklaratimeve dhe përbën shkak për skualifikim nga procedura.*

*KVO konstaton qe operatori ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna, dokumenta referues dhe/ose adresat për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme. Qendrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimeve Publike me ane te vendimit Nr.209/2025, date 07.02.2025, i cili ka theksuar se: "Formulari Përmbledhes i Vetedeklarimit duhet te plotesohet ne te gjithe seksionet e saj duke dhene deklaruar adresen apo dokumentin konkret mbi bazen e te ciles/cilit autoriteti mund te beje verifikimin e vetdeklarimeve dhe mosplotesimi i tij ne te gjithe seksionet perkatese perben kusht skualifikimi".*

*Te njejtin qendrim KPP ka mbajtur edhe me Vendimet Nr.816/2025, date 27.06.2025 dhe Nr.1264/2025, date 17.09.2025.*

*Per sa me siper operatori ekonomik skualifikohet.*

*2. Operatori ekonomik "REJ" sh.p.k. nuk ka përmbushur kërkesën e përcaktuar në kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.7, e cila përcakton se:*

*“Operatori ekonomik ofertues, për solucionet dhe produktet larës dhe dezinfektues të renditura në pikën 3, 4, 5, dhe 6 të Seksionit 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit, Shtojca 8, duhet të paraqesë: dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar nga prodhuesi.”*

*Në përmbushje të kësaj kërkesë, operatori ekonomik ka paraqitur një autorizim datë 09.10.2025, të lëshuar nga shoqëria “GET klin” sh.p.k., me NIPT: L82420502U, i cili paraqitet në dokument si prodhues i detergjenteve, së bashku me dokumente MSDS për produktet përkatëse.*

*Nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), në rubrikën “Leje/Licenca të lëshuara nga QKB”, rezulton se subjekti “GET klin” sh.p.k., NIPT: L82420502U, nuk është i pajisur me Leje/Licencë per Prodhim te Detergjenteve dhe nuk eshte i pajisur me asnje lloj Licence tjeter si prodhues apo leje mjedisore si prodhues I Detergjenteve sipas nenit 4 të Ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, si dhe Shtojcën 1 të këtij ligji (ndryshuar me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020), ku përcaktohet qartë se: “Për veprimtarinë 4.9 – Prodhimi dhe përpunimi/përzjerja e produkteve të pastrimit/detergjenteve”*

*Kjo do të thotë se, çdo subjekt që ushtron aktivitet prodhimi ose përpunimi të detergjenteve, duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisore “Për veprimtarinë 4.9 – Prodhimi dhe përpunimi/përzjerja e produkteve të pastrimit/ detergjenteve”, të lëshuar nga autoritetet kompetente.*

*Në mungesë të një Leje që vërteton se kjo shoqëri është prodhues i produkteve detergjentë, rezulton se MSDS-të nuk janë të lëshuara nga prodhuesi, siç kërkohet shprehimisht nga dokumentet e tenderit.*

*Për rrjedhojë, KVO vlerëson se operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.7, pasi dokumentet e paraqitura nuk i referohen një prodhuesi të ligjshëm të detergjenteve, duke mos garantuar kështu përmbushjen e specifikimeve teknike dhe kërkesave të sigurisë të parashikuara në tender.*

*Për sa më sipër, në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. skualifikohet nga procedura e prokurimit.*

*3. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. ka paraqitur për artikullin nr.3 (“Solucion zbardhues që përdoret për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve”) produktin “Rea Triplex”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS), të përpiluar nga “Get Klin” sh.p.k.*

*Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kërkesat e Specifikimeve Teknike për arsyet si vijon:*

- Dokumentacioni i paraqitur nuk përmban asnjë referencë që produkti të përdoret specifikisht për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve, siç kërkohet shprehimisht në*

DST.

- Nuk përmendet se produkti heq pikat e bardha të ujit (lloji i mbetjeve gëlqerore që formohen në sipërfaqe sanitare).
- Nuk jepen udhëzime për raportin e hollimit 1:150–1:200 me ujë, siç kërkohet specifikimi teknik. (Në specifikimin teknik të dokumenteve të tenderit kërkohet që produkti të përdoret edhe për larjen e pllakave të poshtme të tualeteve me hollim 1:150 – 1:200 me ujë. Në MSDS-në e paraqitur nga operatori ekonomik për produktin “Rea Triplex”, nuk jepen udhëzime mbi raportin e hollimit ose mënyrën e përdorimit të produktit në kushte të aplikimit praktik.
- Dokumenti nuk provon se produkti bën pjesë në një linjë profesionale pastrimi, siç kërkohet për produktet e kategorisë sanitare industriale dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin percaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”. Për sa më sipër, produktit “Rea Triplex” i mungon përputhshmëria e plotë teknike dhe dokumentare me kërkesat e artikullit 3 të Specifikimeve Teknike dhe me kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.7 (MSDS të lëshuar nga prodhuesi). Si rrjedhojë, operatori ekonomik nuk konsiderohet përmbushës për këtë artikull dhe produkti nuk mund të merret në konsideratë për përmbushjen e kërkesave të kontratës.

4. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. ka paraqitur, për artikullin nr. 4 (“Solucion për larje pllakash dyshemeje”), produktin “Rea Triplex”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS), të përpiluar nga “Get Klin” sh.p.k.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe të MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.3.7, në kombinim me Seksionin 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”, që lidhen me solucionet e renditura në pikat 3, 4, 5 dhe 6 “Solucionet dhe produktet larës dhe dezinfektues”, për arsyet si më poshtë:

Sipas specifikimeve teknike, për artikullin Nr.4, kërkohet: “Solucion për larje pllakash dyshemeje. Të jetë sa më i koncentruar (1:200 me ujë). Të lërë aromë të lehtë pas larjes. Të jetë prodhim me standarde të BE-së dhe i certifikuar sipas këtyre standardeve. Të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Masa nga 1 deri në 10 litra. Të jetë linjë profesionale. Niveli i pH (8 +/- 5%).”

Operatori ekonomik i referuar më sipër ka paraqitur MSDS për produktin “Solo Pavimenti 1L”, i cili, sipas dokumentit, është zbardhues dhe dezinfektues. Nga analiza rezulton se ky produkt nuk përmbush specifikimet teknike të publikuara në DST për këtë produkt, pasi:

- Nuk jep udhëzime për hollim 1:200 me ujë, siç kërkohet specifikimi teknik;
- Nuk jep asnjë informacion që vërteton se produkti është pjesë e një “linje profesionale”, siç kërkohet në DST dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë

21.1.2010 “Per Detergjentet” ne te cilin percaktohet se: “Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”. Në dokument nuk identifikohet asnjë referencë ndaj përdorimit industrial ose profesional,

• Mungojnë të dhënat për certifikimet ose standardet e aplikueshme (p.sh. EN, ISO, ose CE), që të konfirmonin klasifikimin e produktit sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

5. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. ka paraqitur për artikullin nr. 5 (“Solucion për larje xhamash”) produktin “Rea Cristal”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS) të përpiluar nga “Get Klin” sh.p.k.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe të MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.3.7, në kombinim me Seksionin 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”, për arsyet si më poshtë:

Sipas pikës 5 të specifikimeve teknike, kërkohet:

“Solucion për larje xhamash (me spray). Të jetë prodhim me standarde të BE-së dhe i certifikuar. Të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Të ketë aromë të lehtë. Masa të jetë 500–800 ml me spray. Të jetë linjë profesionale. Niveli i pH (8.5–9).”

Nga shqyrtimi i MSDS-së së produktit “Rea Cristal” rezulton se:

- Megjithatë, MSDS nuk përmban asnjë informacion për masën, paketimin apo ekzistencën e mekanizmit “spray” (500–800 ml), që është kërkesë eksplicite e DST-së;
- Dokumenti është përpiluar nga një subjekt vendas dhe nuk vërteton se produkti është “prodhim me standarde të BE-së”, siç kërkohet në DST;
- Në MSDS nuk specifikohet klasifikimi profesional i produktit (“përdorim profesional”), çka nuk lejon verifikimin nëse produkti i përket “linjës profesionale” të kërkuar dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 te Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” ne te cilin percaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”;

Për rrjedhojë, operatori ekonomik skualifikohet pasi nuk përmbushë kriteret e kualifikimit.

6. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. ka paraqitur për artikullin nr. 6 (“Solucion për larje mobiljesh”) produktin “Ana Mobilje”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS), të përpiluar nga “Get Klin” sh.p.k.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe të MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.3.7, në kombinim me Seksionin 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”, që lidhen me solucionet e renditura në pikat 3, 4, 5 dhe 6 “Solucionet dhe produktet larës dhe dezinfektues”, për arsyet si më poshtë:

Sipas pikës 6 të specifikimeve teknike, kërkohet:

“Solucion për larje mobiljesh (me spray) 500 ml. Të jetë prodhim me standarde të BE-së dhe i

*certifikuar. Të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Të ketë aromë të lehtë. Të jetë linjë profesionale. Niveli i pH (8–9).”*

*Nga analiza e MSDS-së së produktit “Ana Mobilje” rezulton se:*

- *Dokumenti nuk përmban asnjë informacion mbi origjinën ose certifikimin e produktit, dhe nuk provon se është “prodhim me standarde të BE-së” apo i certifikuar sipas ndonjë standardi të miratuar nga BE;*
- *MSDS-ja nuk përcakton qartë nëse produkti është “linjë profesionale”, pra nëse është i destinuar për përdorim profesional apo konsumator, siç kërkohet në DST dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10/2016, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”;*

*Persa me sipër, operatori ekonomik skualifikohet.*

*7. Operatori ekonomik “REJ” Sh.p.k, nuk ka paraqitur autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për lëndët biocide që do të përdoren gjatë kryerjes së shërbimit. Sipas pikës 2.3.8 të specifikimeve teknike, çdo ofrues që përdor lëndë biocide duhet të vërtetojë lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar dhe të sigurojë të dhënat e plota të kontaktit për verifikim nga Autoriteti Kontraktor. Sipas analizës së specifikimeve teknike, përdorimi i lëndëve biocide është i paevitueshëm, sepse shërbimi objekt prokurimi kërkon dezinfektim dhe kontroll të mikroorganizmave patogjenë si psh në Sallat e Operacionit, në Ambjentet e Kujdesit Intesiv dhe në ambjentet e tjera Spitalore që janë me risk shumë të lartë infektimi, për të garantuar standardet e sigurisë dhe higjienës të përcaktuara. Pa përdorimin e biocideve të autorizuar, nuk mund të arrihet niveli i kërkuar i pastrimit dhe mbrojtjes, çka e bën të pamundur përmbushjen e kushteve teknike të kontratës.*

*Për shkak të mungesës së dokumentacionit të autorizimit përkatës, oferta skualifikohet.”.*

*II.5. Në datën 13.11.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6073, datë 13.11.2025 dhe numër protokoll nr. 3257/2025, datë 13.11.2025 e operatorit ekonomik “REJ” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK.*

*Gjithashtu ankimuesi kërkon skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “AIR” SHPK, si dhe kërkon shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Clean Fast” SHPK dhe ofertës së operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.*

*II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në*

bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 3257/1 prot, datë 14.11.2025, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK, si dhe lidhur me kërkesën për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “AIR” SHPK dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Clean Fast” SHPK dhe të ofertës së operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Konkretisht referuar objektit të ankesës formulari për publikim u publikua me këtë përmbajtje:

*“[...] Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “REJ” SHPK, e cila kundërshtohet në ankesën me nr. 3257/2025 protokolli, datë 13.11.2025, si më poshtë:*

**“Arsyet e skualifikimit:**

*“1. Operatori ekonomik “Rej” sh.p.k, nuk ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 1, shkronja a), pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, Seksioni D – “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”, nuk ka specifikuar dokumentin apo adresën konkrete ku autoriteti kontraktor mund të verifikojë deklaratimet e mëposhtme:*

- Garantimin e mbrojtjes së të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, sipas legjislacionit në fuqi;*
- Lidhjen e kontratave të punës dhe garantimin e masave të sigurisë e shëndetit në punë, veçanërisht për grupet e rrezikuara;*
- Mungesën e masave ligjore në fuqi të vendosura nga ISHPSHSH, apo adresimin e tyre brenda afateve në rast shkeljesh të konstatuara.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme \_\_\_\_\_*

*Mungesa e informacionit për verifikim e bën të pamundur vërtetimin e deklaratimeve dhe përbën shkak për skualifikim nga procedura.*

*KVO konstaton qe operatori ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna, dokumenta referues dhe/ose adresat për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme. Qendrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimeve Publike me ane te vendimit Nr.209/2025, date 07.02.2025, i cili ka theksuar se: “Formulari Përmbledhes i Vetedeklarimit duhet te plotesohet ne te gjithe seksionet e saj duke dhene deklaruar adresen apo dokumentin konkret mbi bazen e te ciles/cilit autoriteti mund te beje verifikimin e vetdeklarimeve dhe mosplotesimi i tij ne te gjithe seksionet perkatese perben kusht skualifikimi”.*

*Te njejtin qendrim KPP ka mbajtur edhe me Vendimet Nr.816/2025, date 27.06.2025 dhe Nr.1264/2025, date 17.09.2025.*

*Per sa me siper operatori ekonomik skualifikohet.*

2. Operatori ekonomik "REJ" sh.p.k. nuk ka përmbushur kërkesën e përcaktuar në kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.7, e cila përcakton se:

"Operatori ekonomik ofertues, për solucionet dhe produktet larës dhe dezinfektues të renditura në pikën 3, 4, 5, dhe 6 të Seksionit 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit, Shtojca 8, duhet të paraqesë: dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar nga prodhuesi."

Në përmbushje të kësaj kërkesë, operatori ekonomik ka paraqitur një autorizim datë 09.10.2025, të lëshuar nga shoqëria "GET klin" sh.p.k., me NIPT: L82420502U, i cili paraqitet në dokument si prodhues i detergjenteve, së bashku me dokumente MSDS për produktet përkatëse.

Nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), në rubrikën "Leje/Licenca të lëshuara nga QKB", rezulton se subjekti "GET klin" sh.p.k., NIPT: L82420502U, nuk është i pajisur me Leje/Licencë per Prodhim te Detergjenteve dhe nuk është i pajisur me asnjë lloj Licence tjetër si prodhues apo leje mjedisore si prodhues I Detergjenteve sipas nenit 4 të Ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, si dhe Shtojcën 1 të këtij ligji (ndryshuar me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020), ku përcaktohet qartë se: "Për veprimtarinë 4.9 – Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e produkteve të pastrimit/detergjenteve"

Kjo do të thotë se, çdo subjekt që ushtron aktivitet prodhimi ose përpunimi të detergjenteve, duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisore "Për veprimtarinë 4.9 – Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e produkteve të pastrimit/detergjenteve", të lëshuar nga autoritetet kompetente.

Në mungesë të një Leje që vërteton se kjo shoqëri është prodhues i produkteve detergjente, rezulton se MSDS-të nuk janë të lëshuara nga prodhuesi, siç kërkohet shprehimisht nga dokumentet e tenderit.

Për rrjedhojë, KVO vlerëson se operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.7, pasi dokumentet e paraqitura nuk i referohen një prodhuesi të ligjshëm të detergjenteve, duke mos garantuar kështu përmbushjen e specifikimeve teknike dhe kërkesave të sigurisë të parashikuara në tender.

Për sa më sipër, në zbatim të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", operatori ekonomik "REJ" sh.p.k. skualifikohet nga procedura e prokurimit.

3. Operatori ekonomik "REJ" sh.p.k. ka paraqitur për artikullin nr.3 ("Solucion zbardhues që përdoret për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve") produktin "Rea Triplex", të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS), të përpiluar nga "Get Klin" sh.p.k.

*Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kërkesat e Specifikimeve Teknike për arsyt si vijon:*

- *Dokumentacioni i paraqitur nuk përmban asnjë referencë që produkti të përdoret specifikisht për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve, siç kërkohet shprehimisht në DST.*

- *Nuk përmendet se produkti heq pikat e bardha të ujit (lloji i mbetjeve gëlqerore që formohen në sipërfaqe sanitare).*

- *Nuk jepen udhëzime për raportin e hollimit 1:150–1:200 me ujë, siç kërkon specifikimi teknik. (Në specifikimin teknik të dokumenteve të tenderit kërkohet që produkti të përdoret edhe për larjen e pllakave të poshtme të tualeteve me hollim 1:150 – 1:200 me ujë. Në MSDS-në e paraqitur nga operatori ekonomik për produktin “Rea Triplex”, nuk jepen udhëzime mbi raportin e hollimit ose mënyrën e përdorimit të produktit në kushte të aplikimit praktik.*

- *Dokumenti nuk provon se produkti bën pjesë në një linjë profesionale pastrimi, siç kërkohet për produktet e kategorisë sanitare industriale dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”. Për sa më sipër, produktit “Rea Triplex” i mungon përputhshmëria e plotë teknike dhe dokumentare me kërkesat e artikullit 3 të Specifikimeve Teknike dhe me kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.7 (MSDS të lëshuar nga prodhuesi).*

*Si rrjedhojë, operatori ekonomik nuk konsiderohet përmbushës për këtë artikull dhe produkti nuk mund të merret në konsideratë për përmbushjen e kërkesave të kontratës.*

*4. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. ka paraqitur, për artikullin nr. 4 (“Solucion për larje pllakash dyshemeje”), produktin “Rea Triplex”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS), të përpiluar nga “Get Klin” sh.p.k.*

*Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe të MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.3.7, në kombinim me Seksionin 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”, që lidhen me solucionet e renditura në pikat 3, 4, 5 dhe 6 “Solucionet dhe produktet larës dhe dezinfektues”, për arsyt si më poshtë:*

*Sipas specifikimeve teknike, për artikullin Nr.4, kërkohet: “Solucion për larje pllakash dyshemeje. Të jetë sa më i koncentruar (1:200 me ujë). Të lërë aromë të lehtë pas larjes. Të jetë prodhim me standarde të BE-së dhe i certifikuar sipas këtyre standardeve. Të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Masa nga 1 deri në 10 litra. Të jetë linjë profesionale. Niveli i pH (8 +/- 5%).”*

Operatori ekonomik i referuar më sipër ka paraqitur MSDS për produktin “Solo Pavimenti 1L”, i cili, sipas dokumentit, është zbardhues dhe dezinfektues. Nga analiza rezulton se ky produkt nuk përmbush specifikimet teknike të publikuara në DST për këtë produkt, pasi:

- Nuk jep udhëzime për hollim 1:200 me ujë, siç kërkon specifikimi teknik;
- Nuk jep asnjë informacion që vërteton se produkti është pjesë e një “linje profesionale”, siç kërkohet në DST dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: “Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”. Në dokument nuk identifikohet asnjë referencë ndaj përdorimit industrial ose profesional,
- Mungojnë të dhënat për certifikimet ose standardet e aplikueshme (p.sh. EN, ISO, ose CE), që të konfirmonin klasifikimin e produktit sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

5. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. ka paraqitur për artikullin nr. 5 (“Solucion për larje xhamash”) produktin “Rea Cristal”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS) të përpiluar nga “Get Klin” sh.p.k.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe të MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.3.7, në kombinim me Seksionin 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”, për arsye të mëposhtë:

Sipas pikës 5 të specifikimeve teknike, kërkohet:

“Solucion për larje xhamash (me spray). Të jetë prodhim me standarde të BE-së dhe i certifikuar. Të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Të ketë aromë të lehtë. Masa të jetë 500–800 ml me spray. Të jetë linjë profesionale. Niveli i pH (8.5–9).”

Nga shqyrtimi i MSDS-së së produktit “Rea Cristal” rezulton se:

- Megjithatë, MSDS nuk përmban asnjë informacion për masën, paketimin apo ekzistencën e mekanizmit “spray” (500–800 ml), që është kërkesë eksplicite e DST-së;
- Dokumenti është përpiluar nga një subjekt vendas dhe nuk vërteton se produkti është “prodhim me standarde të BE-së”, siç kërkohet në DST;
- Në MSDS nuk specifikohet klasifikimi profesional i produktit (“përdorim profesional”), çka nuk lejon verifikimin nëse produkti i përket “linjës profesionale” të kërkuar dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”;

Për rrjedhojë, operatori ekonomik skualifikohet pasi nuk përmbushë kriteret e kualifikimit.

6. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. ka paraqitur për artikullin nr. 6 (“Solucion për larje mobiljesh”) produktin “Ana Mobilje”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS), të përpiluar nga “Get Klin” sh.p.k.

*Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe të MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.3.7, në kombinim me Seksionin 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”, që lidhen me solucionet e renditura në pikat 3, 4, 5 dhe 6 “Solucionet dhe produktet larës dhe dezinfektues”, për arsytet si më poshtë:*

*Sipas pikës 6 të specifikimeve teknike, kërkohet:*

*“Solucion për larje mobiljesh (me spray) 500 ml. Të jetë prodhim me standarde të BE-së dhe i certifikuar. Të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Të ketë aromë të lehtë. Të jetë linjë profesionale. Niveli i pH (8–9).”*

*Nga analiza e MSDS-së së produktit “Ana Mobilje” rezulton se:*

- Dokumenti nuk përmban asnjë informacion mbi origjinën ose certifikimin e produktit, dhe nuk provon se është “prodhim me standarde të BE-së” apo i certifikuar sipas ndonjë standardi të miratuar nga BE;*
- MSDS-ja nuk përcakton qartë nëse produkti është “linjë profesionale”, pra nëse është i destinuar për përdorim profesional apo konsumator, siç kërkohet në DST dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”;*

*Persa me sipër, operatori ekonomik skualifikohet.*

*7. Operatori ekonomik “REJ” Sh.p.k, nuk ka paraqitur autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për lëndët biocide që do të përdoren gjatë kryerjes së shërbimit. Sipas pikës 2.3.8 të specifikimeve teknike, çdo ofrues që përdor lëndë biocide duhet të vërtetojë lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar dhe të sigurojë të dhënat e plota të kontaktit për verifikim nga Autoriteti Kontraktor. Sipas analizës së specifikimeve teknike, përdorimi i lëndëve biocide është I paevitueshëm, sepse shërbimi objekt prokurimi kërkon dezinfektim dhe kontroll të mikroorganizmave patogjenë si psh në Sallat e Operacionit, në Ambjentet e Kujdesit Intesiv dhe në ambjentet e tjera Spitalore që janë me risk shumë të lartë infektimi, për të garantuar standardet e sigurisë dhe higjienës të përcaktuara. Pa përdorimin e biocideve të autorizuar, nuk mund të arrihet niveli i kërkuar i pastrimit dhe mbrojtjes, çka e bën të pamundur përmbushjen e kushteve teknike të kontratës.*

*Për shkak të mungesës së dokumentacionit të autorizimit përkatës, oferta skualifikohet.”.*

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “REJ” SHPK, në ankesën me nr. 3257/2025 prot, datë 13.11.2025, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “AIR” SHPK, si më poshtë vijon:

### **“Shtojca 11**

*[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]*

### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

## **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT OFERTUESI DEKLARON SE:**

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
  - b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
  - c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
  - ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
  - d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
  - dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
  - e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
  - f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
  - g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
  - gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
  - h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
  - i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
  - j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
  - k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar
- Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.
- Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.
- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :  
Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

**2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit me Kodin II.8.A- shërbime ekspertize higjieno-shendetesore.

2.3.4 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të jashtme e të brendshme, objekt prokurimi, duhet të kenë të punësuar minimumi 50 (pesedhjetë) punonjës, si më poshtë:

Nr.	Pozicioni i punes	Numri i punonjësve
1	Përgjegjës Shërbimi	2 (dy)
2	Punonjës pastrimi/sanitar	47(dyzeteshatë)
3	Shofer për drejtimin e mjeteve të kërkuara	1 (një)
	Totali	50 (pesedhjetë)

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

**a) Për Përgjegjësin e Shërbimit:**

**Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë Inxhinier Mjedisi/kimist/biokimist dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:**

- Diplomë
- CV ku te deshmohet eksperience pune ne kontrata te ngjashme
- Kontratë pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi.

**b) Për punonjësit e pastrimit/ sanitar, të paraqitet:**

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)

**c) Për punonjësit shofer, të paraqitet:**

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)
- Leje Drejtimi në përputhje me mjetet e kërkuara, në zbatim të Legjislacionit në fuqi.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë i angazhuar për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës dhe mund të ndryshohet vetëm me miratimin e AK përfitues.

**2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet, si më poshtë:**

<b>Nr</b>	<b>Emri i mjetit</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasitë minimale</b>	<b>Statusi</b>
1	Makineri larëse tharëse për ambientet e brendëshme	Copë	2 (dy)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim
2	Makineri larese per te gjitha llojet e shtresave (mokat, beton, laminat, etj)	Copë	2 (dy)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim
3	Pajisje për larje në lartësi deri në 20 m me ujë te purifikuar	Copë	1 (një)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim
4	Pompa sperkatese me mjegull të ftohtë, per aplikimin e kimikateve dezinfektues me bateri ose me korent	Copë	10 (dhjetë)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim
5	Kosha të transportit të mbetjeve të mëdhenj, të posaçëm, të mbyllur me kapakë	Copë	20 (njëzetë)	Në pronësi ose me qira, ose në përdorim

6	<i>Karrela për pastrimin me të gjitha mjetet e nevojshme për pastrim</i>	<i>Copë</i>	<i>20 (njëzetë)</i>	<i>Në pronësi ose me qira, ose në përdorim</i>
7	<i>Makinë për larjen e rrugëve (autobot), të pajisur me pompë për larjen e rrugëve me presion, pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesët anësore të tij me kapacitet mbajtës, jo më pak se 5000 litra ujë,</i>	<i>Copë</i>	<i>1 (një)</i>	<i>Në pronësi ose me qira, ose në përdorim</i>
8	<i>Fshese me vakum elektrike për fshirjen e rrugëve, i pajisur me tub thithes për mbeturina urbane (si cigare, shishe plastike të medha dhe të vogla, letra, gjethe pemesh, jashtëqitjet e kafsheve si dhe çdo lloj mbeturine tjeter)</i>	<i>Copë</i>	<i>2 (dy)</i>	<i>Në pronësi ose me qira, ose në përdorim</i>

*Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:*

*Për Mjetet që regjistrohen në regjistrat publikë: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë (të vlefshëm), si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi të mjetit, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore.*

*Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, operatori ekonomik, duhet të paraqesë dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë), ku të identifikohen të dhënat teknike të tyre.*

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.*

*Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “REJ” SHPK, në ankesën me nr. 3257/2025 prot, datë 13.11.2025, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Clean Fast” SHPK, duke i shtuar arsyet e skualifikimit, si më poshtë vijon:

#### **“Shtojca 11**

*[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]*

#### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

## **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT OFERTUESI DEKLARON SE:**

*dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;*

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.*

*Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.*

*Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*

***Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.***

*Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.*

➤ *Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :  
Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.*

➤ *Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

*2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.*

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

*c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

2.3.4 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të jashtme e të brendshme, objekt prokurimi, duhet të kenë të punësuar minimumi 50 (pesedhjetë) punonjës, si më poshtë:

Nr.	Pozicioni i punes	Numri i punonjësve
1	Përgjegjës Shërbimi	2 (dy)
2	Punonjës pastrimi/sanitar	47(dyzeteshtatë)
3	Shofer për drejtimin e mjeteve të kërkuara	1 (një)
	<b>Totali</b>	<b>50 (pesedhjetë)</b>

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

**d) Për Përgjegjësin e Shërbimit:**

**Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë Inxhinier Mjedisi/kimist/biokimist dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:**

- Diplomë
2	<i>Makineri larese për të gjitha llojet e shtresave (mokat, beton, laminat, etj)</i>	<i>Copë</i>	<i>2 (dy)</i>	<i>Në pronësi ose me qira, ose në përdorim</i>
3	<i>Pajisje për larje në lartësi deri në 20 m me ujë të purifikuar</i>	<i>Copë</i>	<i>1 (një)</i>	<i>Në pronësi ose me qira, ose në përdorim</i>
4	<i>Pompa sperkatëse me mjegull të ftohtë, për aplikimin e kimikateve dezinfektues me bateri ose me korent</i>	<i>Copë</i>	<i>10 (dhjetë)</i>	<i>Në pronësi ose me qira, ose në përdorim</i>

5	<i>Kosha të transportit të mbetjeve të mëdhenj, të posaçëm, të mbyllur me kapakë</i>	<i>Copë</i>	<i>20 (njëzetë)</i>	<i>Në pronësi ose me qira, ose në përdorim</i>
6	<i>Karrela për pastrimin me të gjitha mjetet e nevojshme për pastrim</i>	<i>Copë</i>	<i>20 (njëzetë)</i>	<i>Në pronësi ose me qira, ose në përdorim</i>
7	<i>Makinë për larjen e rrugëve (autobot), të pajisur me pompë për larjen e rrugëve me presion, pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesët anësore të tij me kapacitet mbajtës, jo më pak se 5000 litra ujë,</i>	<i>Copë</i>	<i>1 (një)</i>	<i>Në pronësi ose me qira, ose në përdorim</i>
8	<i>Fshese me vakum elektrike për fshirjen e rrugëve, i pajisur me tub thithes për mbeturina urbane (si cigare, shishe plastike të medha dhe të vogla, letra, gjethe pemesh, jashtëqitjet e kafsheve si dhe çdo lloj mbeturine tjetër)</i>	<i>Copë</i>	<i>2 (dy)</i>	<i>Në pronësi ose me qira, ose në përdorim</i>

*Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:*

*Për Mjetet që regjistrohen në regjistrat publikë: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë (të vlefshëm), si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi të mjetit, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore.*

*Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, operatori ekonomik, duhet të paraqesë dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë), ku të identifikohen të dhënat teknike të tyre.*

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.*

*Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “REJ” SHPK, në ankesën me 484/2026 prot., datë 16.02.2026, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, duke i shtuar arsyet e skualifikimit, si më poshtë vijon:

**“Shtojca 11**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]  
**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT OFERTUESI  
DEKLARON SE:**

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :  
Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

**2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.4 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të jashtme e të brendshme, objekt prokurimi, duhet të kenë të punësuar minimumi 50 (pesedhjetë) punonjës, si më poshtë:

Nr.	Pozicioni i punes	Numri i punonjësve
1	Përgjegjës Shërbimi	2 (dy)
2	Punonjës pastrimi/sanitar	47(dyzeteshtatë)
3	Shofer për drejtimin e mjeteve të kërkuara	1 (një)
	<b>Totali</b>	<b>50 (pesedhjetë)</b>

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

**p) Për Përgjegjës të Shërbimit:**

**Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë Inxhinier Mjedisi/kimist/biokimist dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:**

- Diplomë
- CV ku të deshmohet eksperience pune në kontrata të ngjashme
- Kontratë pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi.

**q) Për punonjës të pastrimit/ sanitar, të paraqitet:**

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)

**r) Për punonjës shofer, të paraqitet:**

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)
- Leje Drejtimi në përputhje me mjetet e kërkuara, në zbatim të Legjislacionit në fuqi.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë i angazhuar për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës dhe mund të ndryshohet vetëm me miratimin e AK përfitues.

- Gjithashtu ankimesi “Rej” SHPK në ankesë pretendon se: “Të dy aktet administrative si ai i datës 09.02.2026, rivlerësimi i bërë nga AK dhe vendimi KPP nr. 206/2026, datë 04.02.2026, janë akte absolutisht të pavlefshme pasi kanë dalë në kundërshtim me procedurën që parashikon ligji LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik por më e rënda është se janë akte të nxjerra nëpërmjet mashtrimit.”

II.15. Me shkresën nr. 2982/29 prot., datë 19.02.2026 protokolluar me tonën me nr. 484/2 prot., datë 19.02.2026 me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës së apraqitur nga operatori ekonomik “REJ”SHPK lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr. REF-62426-09-23-2025, me objekt: “Shërbim pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës” autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike vendimin e KSHA për shqyrtimin e ankesës “Vendim K.SH.A. 23/2026” nga ku rezulton se ka vendosur refuzimin e saj duke argumentuar:

## II.

### Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të paraqitur në SPE si dhe informacionit të vendosur në dispozicion nga Njësia e Prokurimit:

#### ARSYETON:

**II.1.** Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues “REJ” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për s’kualifikimin e ofertës së tij pas rivlerëimit në kuadër të zbatimit të Vendimit Nr. 104/2026, datë 20.01.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, KSHA arsyeton se:

Në Nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. 7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. 8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”

Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”

Neni 113 i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë.

2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.

Në nenin 114, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së

*kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.*

*Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*

*Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.*

Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

*“Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit. 2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji; b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore; ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji; d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.*

Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet:

*“Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Në pikën 2 dhe 3 të nenit 30 “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” (i ndryshuar), përcaktohet në mënyrë të qartë se:

*2. Vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare. Këto vendime mund të ankimohen në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji. 3. Në përfundim të shqyrtimit, vendimi i marre nga Komisioni, përveç paleve në proces u behet i njohur*

*edhe subjekteve te tjera qe preken nga ky vendim, si edhe publikohet ne faqen e internetit te ketij institucioni brenda 2 diteve nga dalja e tij."*

Së pari, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave referuar legjislacionit në fuqi të sipërcituar thekson se në kuptimin e ligjërimit të ushtrimit të së drejtës së ankimimit përfshihet çdo person që pretendon se ka interes në një procedurë prokurimi, se është dëmtuar ose që rrezikon të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor duke ju referuar një situatë konkrete për të provuar çënimin ose shkeljen e një të drejte ose interesi të ligjshëm, interes i cili individualizohet nga elemente konkrete si subjektet (palët) dhe shkaku (e drejta ose marrëdhënia juridike e çënuar që ndodhet në themel të ankesës).

Operatori ekonomik ankimues, që pretendon se i është çënuar një e drejtë apo interes i ligjshëm, apo që rrezikon t'i çënohet, duhet të identifikojë faktin që përbën çënimin e të drejtës ose interesit të ligjshëm si dhe të drejtën që synon të realizojë, e cila duhet të jetë konkrete dhe të ketë lindur para dorëzimit të ankesës.

Në një vijueshmëri kronologjike të hapave të zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe trajtimit të ankesave, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se:

Në datë 23.09.2025 është publikuar në sistemin e prokurimit elektronik, njoftimi i fituesit paraprak nga ku operatori ekonomik "REJ" shpk rezulton i skualifikuar. Në datë 13.11.2025 operatori ekonomik "REJ" shpk ka paraqitur ankesë duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, kualifikimin e operatorit ekonomik "AIR" shpk dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorët ekonomikë "Pastrime Silvio" shpk dhe "CLEAN FAST" shpk, ankesë kjo e cila është refuzuar nga AK me vendimin e KSHA Nr. 135/2026 prot., datë 21.11.2025.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi ka shqyrtuar ankesën, në përfundim nëpërmjet Vendimit Nr.104/2026, datë 20.01.2026, ka vendosur:

*1. Të pranoje pjesërisht ankesën e operatori ekonomik "REJ" SHPK, për procedurën e prokurimit "Procedurë e Kufizuar mbi Kufirin e Lartë Monetar", me objekt: "Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës", me fond limit 245,035,563.59 (dyqind e dyzet e pesë milion e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e nëntë) Lekë, pa TVSH, ose 2,530,574.86 (dy milion e pesëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, me Nr. REF-62426-09-23-2025, zhvilluar më datë 20.10.2025 nga Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.*

*2. Të pranoje ankesën e operatorit ekonomik "Clean Fast" shpk për procedurën e prokurimit të sipërcituar*

*3. Të mos pranoje ankesën e operatorit ekonomik "Pastrime SILVIO" shpk për procedurën e prokurimit të sipërcituar.*

*4. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorëve ekonomik "REJ" shpk dhe "Clean Fast" shpk dhe të korrigjojë shkeljet sipas konstatimeve më sipër.*

*5. Autoriteti kontraktor brenda 5 diteve të verë ne dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*

*6. T'i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për operatorin ekonomik "REJ" SHPK sipas konstatimeve të mësipërme.*

7. Ngarkohet zyra e finances qe te beje kthimin e tarifes financiare te paguar nga operatori ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK" SHPK. 6. Ngarkohet zyra e finances qe te beje kthimin e tarifes financiare te paguar nga operatori ekonomik "Malvina Visoka" PF.

8. Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën Administrative te Apelit.

9. Kopje e ketij vendimi i dergohet per njoftim Agjencise se Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Referuar Nenit 24 pikat 1 dhe 3 e ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se:

1. Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij. Komisioni i Prokurimit Publik administron të dhënat e Sistemit të Ankesave Elektronike.

3. "Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme. Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit;"

Nenit 118 pika 2 e po këtij ligji parashikohet: "2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji; b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të amulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore; ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji; d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik".

Nenit 35 "Karakteret detyrues të vendimeve", të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021, "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", parashikohet: "1. Vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare. 2. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve nga marrja dijeni duhet të zbatojë vendimin e Komisionit. 3. Struktura përkatëse e Komisionit, monitoron zbatimin e vendimeve nga autoritetet kontraktore, si dhe në mënyrë zyrtare kërkon informacion mbi zbatimin e vendimit, për rastet kur ky informacion mungon apo kërkon zbatimin e vendimit në rastin kur vendimi nuk është zbatuar. 4. Komisioni ka të drejtë të vendosë penaltitete në rastin kur vendimi nuk është zbatuar."

Në referencë me bazën ligjore të sipërcituar rezulton se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike dhe autoritetet kontraktore janë organe përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe njëkohësisht përgjegjëse për

zbatimin e vendimeve të K.P.P-së. Sa më sipër, vendimarrja e KPP-së përbën zgjidhjen në thelb të çështjes nga njëra anë, si edhe efektin detyrues të saj për palët referuar dispozitivit të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe arsyen e vendimarrjes dhe eliminimi i të cilave apo dhe tejkalimi i zbatimit do të cënonte parimin e sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Siguria juridike nënkupton ndërmjet të tjerave, garantimin e besueshmërisë së individit (operatorëve në rastin konkret) tek shteti, institucionet e tij dhe aktet që ato nxjerrin. Duke qënë se vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare, autoriteti kontraktor duhet të zbatojë vendimin e KPP-së, në përputhje me të gjitha percaktimet e tij.

Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka kryer rivlerësimin në zbatim të plotë të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, konfirmuar edhe në shkresën e këtij të fundit Nr. 3257/18, datë 13.02.2026, protokolluar me tonën me Nr. 2982/25.Prot., datë 16.02.2026, ku konfirmoht zbatimi i plotë i vendimit të KPP Nr. 104/2026, datë 20.06.2026. Në këtë shkresë ndër të tjera citohet se: *"..... Gjithashut në seksionin "Hetim" në sistemin e prokurimit elektronik rezulton se më datë 26.01.2026 autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit"*. Nëpërmjet Vendimit Nr. 206/2026, datë 04.02.2026 të KPP-së është lejuar Autoriteti Kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës.

Për sa më sipër, në kushtet kur Komisioni i Prokurimit Publik është shprehur me vendim përfundimtar mbi procedurën e prokurimit, dhe ky vendim është vënë në zbatim nga Autoriteti Kontraktor në përputhje të plotë me detyrimet e përcaktuara në të, rezulton se faza administrative e shqyrtimit të ankesës është shndërruar në shteruese në kuptimin e ezaurimit të afateve. Vendimarrja e KPP-së përbën akt administrativ përfundimtar në kuptim të legjislacionit për prokurimin publik, i cili prodhon efekte juridike të detyrueshme për palët dhe për Autoritetin Kontraktor. Për rrjedhojë, në rastin konkret, nuk ekziston më një afat ankimi administrativ, pasi mjeti administrativ i ankimit është konsumuar me shqyrtimin dhe vendimarrjen e KPP-së. Legjislacioni për prokurimin publik nuk parashikon paraqitjen e një anese të re administrative ndaj të njëjtit objekt dhe mbi të njëjtat pretendime pas një vendimi përfundimtar të KPP-së.

Çdo paraqitje e mëtejshme e pretendimeve në rrugë administrative do të binte ndesh me parimin e sigurisë juridike dhe me parimin e stabilitetit të akteve administrative. Në këto kushte, pas zbatimit të plotë të vendimit të KPP-së nga Autoriteti Kontraktor (siç rezulton nga evidencat në sistemin elektronik të prokurimit dhe nga korrespondenca me KPP-në, si më sipër cituar), procedura e prokurimit objekt ankimit konsiderohet e rivlerësuar dhe e përfunduar në aspektin administrativ.

Nëse operatori ekonomik ankimues "REJ" shpk pretendon cenim të të drejtave të tij pas vendimarrjes së KPP-së, mjeti juridik i disponueshëm është vetëm ndjekja e rrugës gjyqësore, brenda afateve dhe kushteve të parashikuara nga legjislacioni përkatës, dhe jo paraqitja e një anese të re administrative pranë Autoritetit Kontraktor apo KPP-së.

**Për sa më sipër, pretendimet e Operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.**

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), si dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

### **VENDOSI**

1. Të refuzojë ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “REJ” shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.

II.16. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 *te lex specialis* në sistemin e ankesave elektronike.

## **III**

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “REJ” SHPK të paraqitura në ankesën me nr. 484/2026 prot., datë 16.02.2026 dhe numër ankimi elektronik A/2026/6232, datë 16.02.2026, të cilat lidhen me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK, skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “AIR” SHPK, si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Clean Fast” SHPK dhe ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, sqarojmë se këto pretendime lidhen me vendimmarrjen e mëparshme të Komisionit të Prokurimit Publik, për të cilën KPP me shumicën

e anëtarëve është shprehur me vendimin Nr.104/2026, datë 20.01.2026, bashkëlidhur të cilit gjendet dhe mendimin kundër i njërit prej anëtarëve.

III.1.1. Komisioni i Prokurimit Publik, sjell në vëmendje të ankimuesit nenin 110, pika 2 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se:

*“Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

*2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*

Ndërsa në nenin 118 pika 2 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet:

*“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:*

*a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;*

*b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;*

*c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;*

*ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;*

*d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.”*

III.1.2. Nga interpretimi në tërësi i dispozitës së sipërcituar, del qartë qëllimi i normës juridike lidhur me të drejtën që gëzojnë operatorët ekonomikë për të ankimuar çdo lloj vendimi të marrë nga autoriteti kontraktor, i cili ka dëmtuar ose rrezikon të dëmtojë interesat e tyre në procedurat e prokurimit. Gjithashtu, në nenin 118 të LPP, Komisioni i Prokurimit Publik, ndër të tjera, në vendimmarrjen e tij, mund të pranojë ankesën e operatorit ekonomik dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim të nxjerrë në kundërshtim me ligjin, ose të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore. Gjithashtu, në mbështetje të dispozitave të mësipërme, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedure, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.

Nga shqyrtimi i pretendimeve të ankimuesit “REJ” SHPK konstatohet se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK, skualifikimin e ofertës së paraqitur nga

operatori ekonomik “AIR” SHPK, si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Clean Fast” SHPK dhe nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, në këtë procedurë prokurimi për të cilat KPP është shprehur me vendimin Nr.104/2026, datë 20.01.2026, bashkëlidhur të cilit gjendet dhe mendimin kundër i njërit prej anëtarëve.

III.1.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret, pretendimet e mësipërme të parashtruara në ankesë nga operatori ekonomik “REJ” SHPK, përbëjnë “gjë të gjykuar”, për të cilat Komisioni me shumicën e anëtarëve është shprehur në vendimin Nr.104/2026, datë 20.01.2026, mbi bazën e ankesës me nr. 3257/2025, datë 13.11.2025 dhe numër ankimi elektronik A/2025/6073, datë 13.11.2025 të paraqitur nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, për procedurën në fjalë, vendim i cili në rastin konkret sipas vendimmarrjes së shumicës në bazë të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, përkatësisht nenit 30 pika 2, është administrativisht përfundimtar. Në këtë kuptim, kjo çështje e pretenduar merr cilësinë e një çështje të shqyrtuar tashmë nga KPP sipas vendimmarrjes së shumicës por edhe mendimit kundër të njërit prej anëtarëve, situatë kjo, analoge me çështjet që janë gjykuar njëherë nga gjykata, për të cilat zbatohet parimi i gjësë së gjykuar dhe për rrjedhim, *ipso lege*, pretendimet nuk mund të merren në shqyrtim. *Res judicata* është një institut i rëndësishëm në sistemin e drejtësisë, e që lidhet ngushtë me Parimin e Sigurisë Juridike dhe me të drejtën e një procesi të rregullt gjyqësor. Siguria juridike në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje juridike, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Duke e parë në këtë këndvështrim edhe në procesin administrativ meqenëse në kuptim të nenit 30 pika 2 të *lex specialis* vendimet e marra nga Komisioni (pavarësisht nëse merren në mënyrë unanime apo me shumicën e votave të anëtarëve të tij) janë administrativisht përfundimtare, ato nga pikëpamja e ankimit administrativ nuk mund të vihen në dyshim. Qëllimi i këtij instituti në kontekstin administrativ në të cilin i shtrin efektet vendimmarrja e KPP (unanime apo me shumicën e votave të anëtarëve të saj), është jo vetëm që parandalon shqyrtimet e ardhshme që të kundërshtojnë ato të mëparshme, por gjithashtu i pengon ankimuesit të shumëfishojnë të njëjtat pretendime si dhe konfuzionin.

III.1.4. Gjykata Kushtetuese, është shprehur disa herë mbi parimin e “gjësë së gjykuar”. Sipas saj, “në aspektin formal e procedural, gjë e gjykuar nënkupton mosankueshmërinë e vendimit, përfshirë vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës<sup>1</sup>, ndërsa, në atë substancial, nënkupton fuqinë e detyrueshme të vendimit”<sup>2</sup>. Ndërkohë, në një vendim tjetër, Gjykata Kushtetuese ka lënë të kuptojë se “gjë e gjykuar” mund të përkohë me “formën e prerë”, duke u shprehur se: Parimi i gjësë së gjykuar (*res judicata*) pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Gjykata ka vlerësuar se vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje e konkretizimit të së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t’i japë jo vetëm qartësi, por dhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në

<sup>1</sup> Vendim nr.24, datë 12.11.2008 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>2</sup> Vendim nr.29, datë 21.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese.

cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike<sup>3</sup>. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin.

III.1.5. KPP thekson faktin, se fuqia e “*res judicata*” (gjësë së gykuar) mbulon jo vetëm pjesën urdhëruese të vendimit administrativ përfundimtar apo edhe të mendimit kundër të pakicës, por edhe rrethanat e çështjes, të pranuar në shqyrtim, përfundimet dhe arsyet në të cilat është mbështetur ai vendim në pjesën arsyetuese dhe që kanë lidhje me atë që urdhëron organi administrativ në dispozitivin e vendimit të tij.

III.1.6. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 30 pika 2 të Ligjit nr.162/2020, ku përcaktohet shprehimisht se: “*Vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare. Këto vendime mund të ankimohen në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji*”, gjykon, se pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK, në thelb përbëjnë rishikimin e vendimit të mëparshëm, i cili referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik nuk mund të kërkohet nga operatorët ekonomikë.

Gjithashtu, KPP gjen me vend të theksojë, se çdo subjekt i LPP-së ka të drejtë të interpretojë dispozitat e këtij legjislacioni, por gjithashtu, këto subjekte kanë edhe detyrimin ta interpretojnë atë në përputhje e harmoni të brendshme dhe të jashtme me legjislacionin tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë. KPP në cilësinë e organit më të lartë në fushën e prokurimit publik, ka të drejtën dhe përgjegjësinë të bëjë interpretimin përfundimtar të legjislacionit të fushës përkatëse.

III.1.7. Akoma më tej, referuar nenit 30 pika 2 të Ligjit nr.162/2020, ku përcaktohet shprehimisht se: “*Vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare. Këto vendime mund të ankimohen në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji*”, si dhe nenit 121 pika 1, të Ligjit nr. 162/2020, ku përcaktohet se: “*Ndaj vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik palët e interesuara kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën Administrative të Apelit, që shqyrton mosmarrëveshjet administrative, sipas afateve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi*”, sqarojmë, se ashtu sikundër përcaktohet edhe në dispozitivin e vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik, operatorët ekonomikë, në të gjitha rastet kur mendojnë se vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik (në këtë rast vendimi i shumicës) kanë cenuar interesat e tyre të ligjshëm, mund të ndjekin hapat e mëtejshëm, për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Sa më lart pretendimet e ankimuesit “REJ” SHPK nuk merren në shqyrtim.

---

<sup>3</sup> Vendim nr.2, datë 16.01.2013 i Gjykatës Kushtetuese.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “REJ” SHPK se: *“Të dy aktet administrative si ai i datës 09.02.2026, rivlerësimi i bërë nga AK dhe vendimi KPP nr. 206/2026, datë 04.02.2026, janë akte absolutisht të pavlefshme pasi kanë dalë në kundërshtim me procedurën që parashikon ligji LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik por më e rënda është se janë akte të nxjerra nëpërmjet mashtrimit.”* KPP vëren se,

Për ankesën me numër ankimi elektronik A/2025/6073, datë 13.11.2025 dhe numër protokoll nr. 3257/2025, datë 13.11.2025 të operatorit ekonomik “REJ” SHPK për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-62426-09-23-2025, me objekt: “Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 245,035,563.59 (dyqind e dyzet e pesë milion e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH ose 2,530,574.86 (dy milion e pesëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 20.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A, Komisioni i Prokurimit Publik (në vijim KPP) është shprehur me vendimin nr. 104/2026, datë 20.01.2026 ku në pikat 4 dhe 5 të dispozitivit të vendimit të shumicës ka vendosur:

*“4. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorëve ekonomikë “Rej” SHPK dhe “Clean Fast” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet sipas konstatimeve më sipër.”*

*5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.*

Në përmbushje të urdhërimeve të pikës 5 të dispozitivit të vendimit si më sipër cituar autoriteti kontraktor ka dokumentuar pranë KPP zbatimin e vendimit përmes shkresës me nr. 2982/21 prot., datë 27.01.2026, protokolluar me tonën nr. 3257/11 prot., datë 29.01.2026, duke i bashkëngjitur shkresës edhe procesverbalin e datës 26.01.2026 për rivlerësimin e procedurës.

KPP në përmbushje të detyrimeve ligjore pas administrimit të dokumentacionit të dorëzuar lidhur me zbatimin e vendimit nr. 104/2026 datë 20.1.2026 në kombinim dhe me verifikimet e kryera në sistemin e prokurimit elektronik përmes vendimit nr. 206/2026 datë 04.02.2026 ka proceduar me lejimin e autoritetit kontraktor për vijimi me hapat e mëtejshëm të procedurës pasi jo vetëm nga procesverbali i rivlerësimit të ofertave i datës 26.01.2026 i dërguar në KPP nga autoriteti kontraktor por dhe nga raporti i auditit (Call Profile:REF-62426-09-23-2025) rezulton se janë rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “REJ SHPK. Gjithashtu në seksionin “Hetim” në sistemin e prokurimit elektronik rezulton se me datë 26.01.2026 autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës e prokurimit.

Sa më sipër, vendimmarrja e KPP në vendimin nr. 206/2026 datë 04.02.2026 është e mbështetur në fakte dhe prova të cilat kanë çuar në lejimin e autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit “REJ” SHPK nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “REJ” SHPK, për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-62426-09-23-2025, me objekt: “Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 245,035,563.59 (dyqind e dyzet e pesë milion e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH ose 2,530,574.86 (dy milion e pesëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 20.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.
  2. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit obeit ankimi.
  3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “REJ” SHPK.
  4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

<b>Anëtar</b> <b>Kreshnik Ternova</b>	<b>Anëtar</b> <b>Anila Malaj</b>	<b>Anëtar</b> <b>Gjergj Mersini</b>
--	-------------------------------------	--

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

